REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA SARANDË

Sarandë, më 15 . 09.2021

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESEM 2022-2024

Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), mbështetet në ligjin *nr. 9936, datë 26.06.2008 për, "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes* vendore" dhe në Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor.
Në bazë të Planit Kalendar të Përgatitjes së PBA 2022-2024, si dhe, *Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018* të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin Nr.7, date 26.02.2021 të MFE për **Përgatitjen e PBA Vendor 2022-2024,** u puna nga strukturat përkatëse të ekzekutivit vendor, për të përcaktuar ***nivelin e të ardhurave dhe tavanin e shpenzimeve publike***, në nivel programi, për periudhën afatmesme 2022-2024.

Në parashikimin e këtyre treguesave të rëndësishëm të *Programit Buxhetor AM 2022-2024,* u mbështetëm në *infrastrukturën ligjore e n/ligjore përkatëse* të *MFE* në metodologjinë e planifikimit prognozë si dhe në ecurinë e realizimin faktik gjatë periudhës 2019-2020 e në të pritshmin e vitit 2019. Gjithashtu u jemi referuar niveleve të parashikuar në buxhetin AM vendor 2021-2023 si dhe, në rekomandimet e udhëzimet e strukturave përkatëse të ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Përcaktimi i nivelit të të ardhurave sipas zërave e burimeve të krijimit si dhe i ***tavaneve limit të shpenzimeve publike në nivel programi***, përbëjnë domosdoshmëri për një zhvillim të qëndrueshëm afat-mesëm vendor**.**

Baza mbi të cilën janë përcaktuar sektorët parësorë të zhvillimit dhe identifikimit të prioriteteve të shpërndarjes së burimeve për periudhën 2022-2024 janë kërkesat e qytetarëve, të shprehura përmes diskutimeve publike me qytetarët e njësive administrative dhe programi qeverisës i Kryetarit të Bashkise per periudhen 2022-2024.
Programit Zhvillues Afatmesëm 2022-2024 projekton pritshmëritë në zhvillimet makro-ekonomike të njësisë vendore në horizontin kohor afat-mesëm si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve vendore, në nivel programi. Përcakton gjithashtu, synimet e politikat e vetqeverisjes vendore në lidhje me treguesit kryesorë të zhvillimit vendor e të politikës fiskale, pritshmëritë ekonomike për vitin aktual 2021 si dhe për tre vitet e ardhshëm 2022-2024. Treguesit që janë programuar në raportin e paraqitur jane rezultat i rishikimit dhe përditësimi përgjatë vitit në vijim 2021. Hartimi i këtij dokumenti nga ekzekutivi vendor shërben

për të bërë me dije Këshillin Bashkiak dhe komunitetin vendor lidhur me ***mundësitë potenciale zhvilluese të njësisë vendore*** për tri vitet e ardhshme.

Objektivat e Programit Buxhetor Afatmesëm:

- ✓ Përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritja e efiçencës së përdorimit të fondeve buxhetore, është objektivi parësor i PBA-së, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e me përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesëmarrëse në PBA, mbetet thelbësore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.
- ✓ Sigurimi i një shpërndarjeje dhe përdorimi efektiv dhe efiçent i burimeve është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet:
  - Një planifikim i qëndrueshëm afatmesëm, brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore,
  - Forcimi i lidhjes mes programeve të Bashkisë dhe alokimit të burimeve.

Qëllimet e Programit Buxhetor Afatmesëm:

- ✓ Krijimi i një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve politike, të shprehura në programin politik të Bashkisë së Sarandës, dhe prioriteteve në shpenzime me qëllim shpërndarjen efektive të burimeve në dispozicion;
- ✓ Zgjerimi i vizionit të procesit të buxhetimit duke synuar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3-vjeçare);
- ✓ Një parashikim më i mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhë tre vjeçare, për të gjitha programet e shpenzimeve;
- ✓ Inkurajimi i efektivitetit, efiçencës dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike dhe alokimin e burimeve;

Struktura e përgjithshme e Programit Buxhetor Afatmesëm:

PBA-ja është hartuar në bazë të programeve, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, brenda të cilit janë përfshirë një ose më shumë Njësi Shpenzuese, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse. Dokumenti i PBA-së, prezanton me detaje qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program. PBA-ja është hartuar për të gjitha programet e Bashkisë dhe është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit duke u ndërthurur me programin politik të Kryetarit të Bashkisë.

Prioritete të bashkisë për këtë periudhë afatmesme janë

- Zhvillimin e integruar teritorial të njësisë vendore dhe të njësive administrative.
- Zhvillimit të industrisë turistike.
- Përmirësimi i furnizimin me uje te pishem.
- Permiresimi i infrastruktures rrugore sidomos ne brendesi te lagjeve.
- Shtimi i kanalizimet e UZ edhe ne rrethinat e qytetit.
- Ambiete shlodhese, hapesira te gjelbra, kende sportive, kende shlodhese per te moshuar.
- Shtim te ndricimit publik.
- Permiresim ne infrastruktures së mesimdhenies etj.

Mbi bazë të këtyre prioriteteve,funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në legjislacion për ushtrim nga Bashkia kemi përcaktuar Programet Buxhetore që do të buxhetohen në përiudhën afatmesme 2022-2024.

Për cdo program janë parashikuar të gjitha shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të të programit dhe kemi parashikuar dhe për Njësive Shpenzuese.

Shpenzimet:

a**.** *Shpenzimet korrente (paga, sigurime, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes)*
b. Shpenzimet kapitale.

Njësitë Shpenzuese:

a. Aparati i Administratës së Bashkisë së Sarandes
b. Institucionet e varësisë

Konsultimi i Programit Buxhetor Afatmesëm:

Në referim te kalendarit te konsultimeve me publikun, u realizuan takime ne zonat e bashkise me grupe modeste banoresh, ne zbatim te rregullave te vendosura per situaten e pandemise se COVID -19. Konsultimi me publikun u be edhe nepermjet sontazheve te zhvilluara nga projekti "bashki te forta" pjese e se ciles eshte edhe Bashkia Sarande. Kerkesat dhe problematikat kryesore te dala nga keto takime, qe kryesisht kishin si referim infrastrukturen publike, ishin ne harmoni me parashikimet e bera ne parashikimin fillestar te programeve te shpenzimeve, sidomos persa I perket investimeve kapitale. Ne zonat periferike kerkesat u fokusuan ne permiresimin e rrjetit te ujit te pijshem dhe rruge te brendshme, te cilat jane parashikuar ne buxhetin afatmesem. Persa I perket zonave urbane kerkesat u perqendruan ne ambiente shlodhese, infrastructure me te permiresuar rrugore, dhe ne te gjithe territorin e bashkise te perbashket kishin kerkesen per permiresimin e infrastruktures shkollore dhe arsimit ne pergjithesi. Brenda mundesise buxhetore dhe kapaciteteve fiskale, kerkesat e publikut pergjithesisht jane reflektuar ne PBA 2022-2024.

- *Ne Lagjet e Bashkise Sarande*, Kerkesat e paraqitura nga qytetaret kane te bejne me furnizimin me uje te pishem, permiresimi i infrastruktures ne rruget e brendshme te njesive, kanalizimet e UZ, mjedise shlodhese per te moshuar dhe argtuese per femije, hapesira te gjelbra, kende sportive, permiresim te ndricimit publik, permiresim ne infrastrukturen e mesimdhenies etj.
- *Në Njësinë Administrative Ksamil***,** banoret e NJA, pjesemarres ne degjesat publike u shprehen se investimet duhet të përqendrohen në infrastrukturen rrugore, ujesjellesin dhe sherbime me cilesore ne pastrim, hapësira çlodhëse, gjelbërimi dhe kënde lojërash.
- *Ne fshatrat Metoq dhe Gjashte*, paraqet se nevojat për investim janë më së shumti për, infrastruktura rrugore, trotuare, terrene për veprimtari sportive si edhe kënde lojërash dhe shërbim social, furnizimi me uje ne orare me te zgjatura.
- *Në fshatin Shelegar* , kerkesat kryesisht ishin per infrastructure rrugure, ndricim, hapesira shlodhse si edhe furnizimi me uje ne mase te pershtatshme.
- *Ne fshatin Berdenesh e Manastir* kerkesat per investime ishin per ujesjelles kanalizime, infrastrukture rrugore .
- *Ne fshatin Cuke* , kerkesat per projektbuxhetin ishin per ndertimin e terreneve sportive, shtim te hapesirave publike te gjelbera dhe kende lojnash dhe hapesira shpolodhese per te moshuar.

Ne progamet e buxhetit jane parashikuar pergjithesisht kerkesat e dala nga takimet e mesiperme duke i listuar sipas prioriteteve. *Tavanet e* shpenzimeve publike hartohen mbi bazën e historikut dhe të analizës të ecurisë së shpenzimeve faktike në periudhen trevjecare. Në gjithë këtë proçes merr rëndësi të veçantë përcaktimi i drejtë i burimeve vendore nga taksat dhe tarifast vendore, si edhe atyre të mbështetura nga burimet qëndrore e alternative. Nga analiza e ecurisë së dinamikës

së zhvillimit të burimeve vendore evidentohet qasje pozitive e rritjes së nivelit të tyre nga një viti në tjetrin duke rritur në këtë mënyrë edhe shanset për realizimin e buxhetit ne terma vjetore dhe afatmesem.

Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Sarande në vitet 2022-2024

I. Të ardhurat e rishikuara për vitet 2022-2024

Rishikimi i parashikimit te kapaciteteve të burimeve vendore shërben për të projektuar sa më drejt potencialet zhvilluese afatmesëm, të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Për këtë i kemi kushtuar një rëndësi të veçantë këtij momenti, duke përditësuar nivelin e tyre me qëllim mobilizimin maksimal të kapaciteteve fiskale vendore në dispozicion të zhvillimit. Kjo na mundëson hapa të sigurtë e të qëndrueshëm për hartimin e një ***programi real zhvillimi***, i cili do të garantojë zgjerimin dhe rritjen e efiçencës së përdorimit të inputeve vendore.
Realizimi faktik i vitit 2020 ne shumen 431,283 mije lek dhe pritshmëritë e të ardhurave për vitin 2021, janë dy faktor të cilët kanë impononuar rishikimin e të ardhurave në buxhetin afatmesëm 2022-2024 dhe për parashkimet buxhetore të vitit 2022. Programi afatmesëm i përditësuar mbështet më fuqishëm zhvillimin e integruar teritorial të njësisë vendore dhe të zonave juridike administrative. Me përparësi ai mbështet, zbatimin e politikave të *Kryetarit te Bashkise* në fushën e *investimeve* e të *shërbimeve publike*, në fushën e *zhvillimit të industrisë turistike e të politikave fiskale e sociale*.
Programi ekspozon *rritje të transparencës* së krijimit e të angazhimit të burimeve publike, *përmirësim të performancës së kapaciteteve administrative e të barazisë gjinore*.

Programimi i nivelit të të ardhurave vendore e rishikuar, për periudhën ***afatmesme 2022-2024***, është mbështetur në buxhetin faktik të viteve 2019-2020 si dhe në ***paketën fiskale e në buxhetin e miratuar të vitit 2021*** dhe ne performancen e periudhes 8 mujore 2021 te te ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Nga përditësimi i kryer, efektet në rritjen e burimeve vendore të të ardhurave , për të tre vitet, arrijnë në *28 milion lekë*, mesatarisht *9 milion lekë*, në vit, kjo e ndikuar edhe nga efekti negativ ne ekonomi e pandemise Covid 19. Për të krijuar një vizion më të plotë mbi ecurinë e burimeve vendore sipas viteve, në periudhën afatmesme 2022-2024, po japim më poshtë një tabelë përmbledhëse të të ardhurave.

Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit


Burimet e financimit të buxhetit për Bashkinë e Sarandes, përbëhen nga:

1. Të ardhurat e veta:
2. Transferta e pakushtëzuar.
3. Transferta e kushtëzuar;

Tabela1. Parashikimi i te ardhurave per periudhen 2022-2024

Nr	Emertimi i të Ardhurave Tatimore	Fakti 2019	Faki 2020	Buxheti 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
	Te ardhurat e veta	405,013	431,283	432,000	448,050	452,470	460,300
I.	***Të ardhura nga taksa***	**282,248**	**300,668**	**286,500**	**301,600**	**301,870**	**305,400**
1	Taksa & Tatim thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël	12,614	11,212	1,000	500	0	**0**
2	Taksa mbi Ndërtesat	79,500	67,978	90,000	95,500	96,000	98,000
3	Taksa mbi token bujqësore	3,550	3,100	6,000	7,000	7,270	7,300
4	Taksa e fjetjes në hotel	23,906	11,070	24,000	25,500	26,500	27,000
5	Taksa e ndikimit në infrast. nga ndërtimet e reja+Legaliz.	86,350	113,920	73,000	74,000	70,500	70,000
6	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pron.pasuritë e paluaj.	7,845	5,466	8,500	10,000	10,500	11,000
7	Taksa vjetore e mjeteve te përdorura	22,550	23,584	19,000	24,000	24,500	25,000
8	Taksa për zënien e hapësirave publike	40,000	54,120	51,000	47,000	47,500	48,000
9	Taksa e tabelës	625	1,074	3,000	3,200	3,200	3,200
10	T'Ardhura nga vitet e kaluara	805	695	2,000	3,500	3,500	3,500
11	Taksa trualli	437	218	3,000	4,000	4,500	4,500
12	Takse e rentës minerare	0	0	0	0	0	0
13	Taksa për zënien e hap.publike për reklama	4,066	2,258	6,000	7,000	7,500	7,500
14	T' ardhura nga titimi mbi t'ardh.personale (2 %)	0	5,973		400	400	400
II.	**Të ardhura nga tarifat**	**118,090**	**109,213**	**131,600**	**132,600**	**136,250**	**140,450**
1	Tarifa për pastrim + gjelberim & ndricim (shërb.publ.)	89,665	68,000	73,000	70,000	71,350	73,000
2	Tarifa për hapësira publike e kontrollin teritorit			1,800	1,950	2,000	2,500
3	Tarife ndriçimi publik		6,000	15,000	17,000	17,500	17,900
4	Tarife për trajtimin mbetjeve inerte landfilli Volloder		2,000	2,000	2,000	2,000	2,100
5	Tarife gjelbërimi		6,117	7,000	7,500	8,000	8,500
6	Tarifa të ndryshme pyje-kullota, shërb.zjarrfikës,leje tran.		1,800	1,850	1,850	1,900	1,950
7	Tarifa parkimi	1,665	1,608	2,500	2,700	2,800	2,950
8	Tarifa për therjen e bagëtive	0	500	500	500	500	500
9	Tarife për shërbime te tjera administrative	19,320	16,542	15,450	17,000	17,500	18,000
10	Tarife për shërbime sociale (arsim parash.çerdhe, konvikte)	7,285	4,593	9,500	8,500	8,600	8,650
11	Sporte dhe kultura,muzeumet, (bileta etj.)	155	53	1,000	1,550	2,000	2,000
12	Tarifa te tjera shërbimi, të shtuara gjatë vitit,ujitje, kanaliz.	0	2,000	2,000	2,050	2,100	2,400
III.	**Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qera**	**4,675**	**21,402**	**13,900**	**13,850**	**14,350**	**14,450**
1	Shitje Troje e pasuri	0	12,398	4,000	3,500	3,500	3,500
2	Qera të ndryshme aseteve vendore	4,635	3,493	5,000	6,000	6,500	6,500
3	Te ardhura te tjera		3,951	1,350	1,350	1,350	1,350
4	Debitore, Interesa e Grante të ndryshme,spons.gjoba etj.	40	1,560	3,550	3,000	3,000	3,100
IV.	**Të ardhurat e veta**	**405,013**	**431,283**	**432,000**	**448,050**	**452,470**	**460,300**
V.	**Të ardhura të tjera**	**433,212**	**408,022**	**439,019**	**370,759**	**369,324**	**361,797**
1	Transferta e Pakushtëzuar	125,697	129,131	145,312	130,312	139,710	149,613
2	Transfertae pakushtezuar sektoriale	100,959	103,707	103,707	106,800	106,800	106,800
3	Te ardhurat te trasheguara nga viti i kaluar	206,556	175,184	190,000	133,647	122,814	105,384
VI.	**Totali i te ardhurav te veta &transferta(IV+V)**	**838,225**	**839,305**	**871,019**	**818,809**	**821,794**	**822,097**
VII.	**Te ardhura te kushtezuara**	**325,806**	**233,773**	**425,000**	**303,205**	**466,534**	**389,000**
1	Transferta te kushtezuara sociale	**192,420**	**220,500**	**225,000**	**227,550**	**228,900**	**229,000**
2	Fondi i Zhvill. Rajon.	**133,386**	**13,273**	**200,000**	**75,655**	**237,634**	**160,000**
VIII	**Te ardhurat gjithsej (VI+VII)**	**1,164,031**	**1,073,078**	**1,296,019**	**1,122,014**	**1,288,328**	**1,211,097**

Grafik 1. Parashikimi I Te ardhurave te Bashkise Sarande per periudhen afatmesme 2022-2024



Referuar legjislacionit në fuqi dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak, për paketën fiskale vendore të Bashkisë Sarande, për mbledhjen e të ardhurave janë përcaktuar strukturat përkatëse, si më poshtë:

- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore;
- Strukturat e Aparatit të Bashkisë;
- Agjentët tatimorë

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, është struktura kryesore, për mbledhjen dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave të Bashkisë së Sarandes, e cila jo vetëm arkëton por dhe monitoron të gjitha strukturat e tjera. Strukturat e Aparatit të Bashkisë janë të angazhuara në arkëtimin e tarifave të shërbimit që aplikon vetë institucioni si dhe në taksat që zbatohen direkt prej tyre.

Agjentët tatimorë të përcaktuar sipas ligjit dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak, janë:

1. Drejtoria Rajonale Tatimore, për arkëtimin e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin e BV;
2. DRSHTRR, për arkëtimin e taksës vjetore të mjeteve të përdorura;
3. ZVRPP, për arkëtimin e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e PP;
4. UKT Sha, për arkëtimin e taksës së ndërtesës, dhe tarifës së pastrimit nga kategoria familjarë;

Në mënyrë të detajuar të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për parashikimin e vitit 2022-2024 në Bashkinë e Sarandes, paraqiten si më poshtë:

A. **T**aksat dhe Tarifat Vendore

A.1 Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, ë) taksa të tjera, të përcaktuara meligj.


Nga *analiza e strukturës së burimeve vendore* arrihet në përfundim se ende vazhdohet që të ardhurat nga taksat vendore zënë një peshë të konsiderueshme e përbëjnë burimin kryesor të të

ardhurave vendore. Në vitin 2022 niveli i të ardhurave nga taksat është parashikuar ***301.6*** *milion* lekë, pothuajse sa niveli i burimeve vendore gjithësej, *(taksa+tarifa)* në vitin 2017, me një rritje relative, midis dy periudhave, me rreth ***40 %*** . Megjithë luhatjet e lehta në strukturë, te ardhurat nga taksat, mbeten edhe për periudhën në vazhdim, burim mjaft i rëndësishëm e me ndikim, në përmirësimin e performancës së financave lokale.

Tabela 2. Te ardhurat nga taksat vendore

	Lloj i i te ardhurave	**Fakt 2019**	**Fakt 2020**	**Parashik 2021**	**Parashik 2022**	**Parashik 2023**	**Parashik 2024**
1	Të ardhurat nga taksat	282,248	300,668	286,500	301,600	301,870	305,400

Grafiku.2 Parashikimi afatmesem i taksave



Taksa mbi ndertesat ze rreth 31% ne burimet vendore. Me ndryshimet e fundit ligjore, të cilat kane marre efekt nga data 1 Prill e vitit 2018, taksa e ndërtesës ka marre një tjetër vlerësim, duke u mbështetur tek vlera e banesave dhe % e caktuar për masën e taksës si për banesat dhe objektet e biznesit. Për këtë qëllim, në bashkepunim me institucionet qendrore por jo vetëm, ka filluar ngritja e bazës së të dhënave për krijimin e kadastrës fiskale si informacion vendimtar për përllogaritjen dhe mbledhjen e të ardhurave. Gjatë viteve 2019 dhe 2020 kjo taksë ka arritur nivelin maksimal të arkëtimit, edhe pse me luhatje te vogla per arsye objektive veçanërisht për kategorinë familjare.

Ndryshimet ne prognoze jane me rritje te lehte ne kete takse, duke u mbeshtetur ne ecurine progresive te realizimit te saj por edhe te ndryshimit ne rritje te bazes se taksueshme, qe eshte prona.

Taksa e ndikimit ne infrastrukture eshte taksa e dyte me me ndikim ne buxhetin e bashkise e cila ze rreth 24, % te buxhetit te te ardhurave nga taksat e bashkise.Planifikimi ne rritje ka qene per arsye te PPV i cili ka bere rritjen e kerkeses per ndertim dhe zhvillim te pronave dhe ndertesave per banim. Per vitet 2022-2024 eshte planifikuar ne qendrushmeri duke parashikuar nje qendrim konstant te kerkesave per lejet zhvillomore te ndertimit.

Taksa e fjetjes ne hotel eshte gjithashtu nje takse me peshte te konsiderueshme per te ardhurat e Bashkise me rreth 8.1% te totalit te taksave. Realizimi 2020 per shkak te pandemise ka nje realizim te ulet, por kjo nuk ndikon qe te planifikojme te ardhurat nga kjo takse ne nje nivel ambicioz per vitet e ardhshme, duke shpresuar ne nje kthim ne normalitet te jetes dhe zhvillimit te turizmit.

Taksa e zenies se hapesires publike gjithashtu eshte nje takse e rendesishme per Bashkine e Sarandes per vete natyren specifike qe ka kjo takse. Kryesisht ne perberjen e saj ka taksimin e hapesirave publike ne plazhe. Realizimi ne nje mase me te larte se parashikimi per vitin 2020, per shkak te saktesimit te siperfaqeve te taksuara, na mundeson parashikimin per nje periudhe afatmesme ne mase me te larte sec ka qene parashikuar ne vitet e meparshme. Saktesimi ne vazhdimesi i siperfaqeve te perdorura na ndikon edhe ne korrektimin e lehte qe kemi bere per vitet 2022-2024.

Taksa vjetore e mjeteve te perdorura eshte nje takse e ndare, e transferuar nga DRTRSH ne reference me numurin e mjeteve te perdorura ne Bashkine e Sarandes, duke perfituar 25% te te ardhurave te gjeneruara

nga totali i kesaj takse. Ne progresion parashikimi eshte me rritje duke pasur parasysh ndryshime te mundshme ligjore dhe rritjen e numrit te mjeteve te transportit.

Tabela 3 . Ecuria e taksesve kryesore ne buxhetin e Bashkise. *ne 000/lek*

Nr	Lloi I takses	*Fakti 2019*	*Fakti 2020*	*Parashikimi 2021*	*Parashikimi 2022*	*Parashikimi 2023*	*Parashikimi 2024*
1	Taksa e fjetjes në hotel	23,906	11,070	24,000	25,500	26,500	27,000
2	Taksa mbi ndërtesat,pronën	79,500	67,978	90,000	95,500	96,000	98,000
3	Taksa e dik.infra.ndërt. reja	86,350	113,920	73,000	74,000	70,500	70,000
4	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	22,550	23,584	19,000	24,000	24,500	25,000
5	Taksa për zënien hapës. publike	40,000	54,120	51,000	47,000	47,500	48,000


A.2 Tarifat vendore.

Në strukturën e burimeve publike të ardhurat nga tarifat vendore , në vitin 2022 synojnë të përbëjnë ***31 %*** të të ardhurave vendore. Qasja pozitive në rritjen më të shpejtë të të ardhurave nga tarifat vendore, në raport me rritjen e burimeve nga taksat, shpreh lehtësimin relativ të ngarkesës fiskale të taksapaguesave si dhe krijimin e raporteve optimalë në mbulimin e kostos së shërbimeve publike që ofrohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Në këtë shtesë me peshë është rritja e tarifave të shërbimeve publike. Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve publike, në ndryshim nga deri tani, janë zbërthyer sipas llojit të shërbimit publik që i ofrohet popullates. Ato pësojnë rreth ***7.5 milion*** lekë rritje në periudhen afatmesme 2022-2024. Në te ardhurat nga tarifat vendore, siç pasqyrohet në tabelën përkatëset, peshën kryesore e zënë te ardhurat nga ***tarifa e shërbimeve publike***, për pastrimin, gjelbrimin dhe ndriçimin. Megjithë përmirësimet ende, pesha e të ardhurave nga tarifat , në strukturën e burimeve vendore, vazhdon të jetë nën mundësitë potenciale. Niveli i te ardhurave publike nga tarifat, megjithë ecurinë pozitive, vazhdon të përbëjë vetëm ***31 %*** të të ardhurave vendore. Vazhdohet të mbulohet rreth ***65 % e*** kostos së shërbimeve publike që njësia vendore ofron në komunitet. Për ndriçimin mbulohen me tarifën e vendosur më pak se ***40 %*** e kostos së shërbimit. Mbeten ende jashtë normimit e mbulimit nga sistemi tarifor shërbimet shtesë gjatë sezonit turistik, shfrytëzimi i hapësirave publike, shërbimi i parkimit etj. Dispropocioni ka ardhë duke u ngushtuar për çdo vit, por ende hapat janë minimalë e, ngelet shumë për të bërë deri në *vendosjen e një ekuivalence të qëndrueshme midis burimeve dhe kostos së këtyre shërbimeve*.

Tabela 4. Te ardhurat nga tarifat vendore

	Lloj i i te ardhurave	**Fakt 2019**	**Fakt 2020**	**Parashik 2021**	**Parashik 2022**	**Parashik 2023**	**Parashik 2024**
1	Të ardhurat nga tarifat vendor	118,090	109,213	131,600	132,600	136,250	140,450

Grafiku 3. Parashikimi Afatmesem i Tarifave Vendore



Me rritje e në përmirësim janë programuar edhe të ardhurat nga tarifat e tjera. Jashtë kësaj pririe është ecuria e tarifave nga parkimi i automjeteve. Niveli i të ardhurave nga kjo tarife për vitin 2021 , për faktorë të ndryshëm e mungesës së infrastrukturës mbështetëse, parashikohet në nivele të ulta .

Tabela 5. Ecuria e tarifave vendore ne periudhen afatmesme

Nr	Lloi I tarifes	Fkti V.2019	Fakti V. 2020	Parashikimi 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
1	Tarifa për shërb.pastrim,gjelb.ndriç.etj	69,665	68,000	73,000	70,000	71,350	73,000
1a.	Tarifa për hapësira publike	1,700	1,750	1,800	1,950	2,000	2,500
1b.	Tarifa për shërbimin e ndriçimit	12,950	13,450	15,000	17,000	17,500	17,900
1c.	Tarifa për shërbimin e gjelberimit	5,190	6,117	7,000	7,500	8,000	8,500
2	Tarifë parkimi mjetesh	1,665	1,608	2,500	2,700	2,800	2,950
3	Tarifë për shërb.të ndryshme administ.	19,320	16,542	15,450	17,000	17,500	18,000
4	Tarifë për shërb.sociale(arsim.konv).	7,285	4,593	9,500	8,500	8,600	8,650

a. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

Tarifës së Pastrimit eshte tarifa me peshe me te madhe ne strukturen e tarifave vendore me rreth 53% te totalit. Kesaj tarife i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Sarandes. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave mblidhet nga dy struktura, përkatësisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore për kategorinë e biznesit dhe Ujësjellës-Kanalizime Tiranë Sha për kategorinë familjarë. Ecuria e arkëtimit të tarifës së pastrimit për të dyja kategoritë si Biznese dhe Familjarë rezulton me rritje progressive. Parashikimi ne buxhetin afatmesemn 2022-2024 eshte bere duke mbajtur parasysh ecurine ne rritje per dy vitet e kaluara si pasoje e ndryshimeve te bazes ligjore , dhe te zgjerimit te bazes se taksimit dhe si rezultat i riorganizimit të mënyrës së mbledhjes së taksës e forcimit të strukturave menaxhuese.

b. Tarifa për shërbime te tjera administrative

Zeri I Tarifave te vendosur per sherbime te tjera administrative, perfshin sherbimet e dhena nga Bashkia me pagese duke perfshire pagesat per leje pune nga ana e drejtorise se sherbimeve, vertetime dhe dublikata te dhena nga drejtoria e urbanistikes, tarifa per vulosjen e veterinare te bagetive te therura, tarifa e lishensimit te veprimtarive te transportit, tarifa e parkimit per mjetet e licensuara dhe vendparkimet publike, tarife per pyjet dhe kullotat, tarife per sherbim shtese nga zjerrfikesja, tarife per trajtimin e mbetjeve inetre ne landfille.
Ne strukturen e buxhetit nga tarifat vendore kjo kategori tarifash ze rreth 13 % .

c. Tarifa te institucioneve te arsimit ,kultures,sportit

Ne strukturen e buxhetit te tarifave ze rreth 8% te totalit te tarifave. Ne kete ze te ardhurash perfshihen te ardhurt nga muzeumet, mencat e konviktit, te kopeshteve dhe cerdheve, biletat e sportit dhe te pallatit te kultures. Per periudhen 2022-2024 eshte bere parashikimi me rritje nga viti ne vit, objektiv dhe duke marre parasysh faktoret qe ndikojne ne ndryshimin e bazes se tarifimit.


- ✓ Transfertat nga Buxheti i Shtetit .
- ✓ Transferta e Pakushtëzuar.

Transfertat e pakushtëzuara, që buxheti qendror i transferon pushtetit vendor, përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transfertat e pakushtëzuara shpërndahen ndërmjet njësive të pushtetit vendor sipas formulës së paraqitur në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" si dhe udhëzimeve plotësues. Transferta e pakushtëzuar për Bashkinë e Sarandes në periudhën 2017 – 2024 paraqitet si vijon:

Tabela 6. Te ardhurat nga transferta e pakushtezuar dhe transferta e sektoriale

	Fakt 2017	*Fakt 2018*	*Fakt 2019*	*Fakt 2020*	*Fakt 2021*	*Parashik 2022*	*Parashik 2023*	*Parashik 2024*
